

| Shkolla / Rryma                | Periudha                  | Mendimtarët Përfaqësues                                                                              | Filozofia / Ideologjia                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|--------------------------------|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Parasokratikët I               | Shek. VI p.e.s            | Thalesi, Anaksimandri, Anaksimeni                                                                    | Me origjinë nga Mileti, qytet bregdetar në Azinë e Vogël, ata u përpoqën të bënin një interpretim racional dhe materialist të universit duke kërkuar të zbulonin parimet bazë të përbërjes së tij. Ruhen vetëm disa fragmente të veprave të parasokratikëve.                                           |
| Parasokratikët II              | Shek. VI p.e.s            | Pitagora, Parmenidi, Herakliti                                                                       | U morën me mënyrën e kuptimit të botës, me të vërtetën dhe mendimin. Për Pitagorën, numrat pasqyronin harmoninë e universit. Parmenidi besonte se "Njëshi është gjithçka". Herakliti pohonte se "E vërteta është absolute dhe e pandryshueshme" dhe se "gjithçka lëviz" dhe asgjë nuk qëndron në vend. |
| Filozofia Klasike I            | Shek. V-IV p.e.s          | Sokrati                                                                                              | Vlerësohet se hodhi bazat e filozofisë. Me pohimin e tij "Di vetëm një gjë, që nuk di asgjë", e përkufizon filozofinë më shumë si një veprimtari, si kërkim të lumturisë nëpërmjet zbulimit të së vërtetës. Mendimi i tij u bë i njohur nëpërmjet Dialogëve të Platonit.                               |
| Filozofia Klasike II           | Shek. V-IV p.e.s          | Platon                                                                                               | Pohoi dualizmin midis shpirtit dhe trupit dhe se të filozofosh-thoshte duhet të braktisë pamjen e jashtme të botës për tu ngjitur tek e vërteta e botës së ideve. Ndër dialogët e tij kryesorë përmenden Banketi, Sofisti dhe Republika.                                                               |
| Filozofia Klasike III          | Shek. IV p.e.s            | Aristoteli                                                                                           | Bashkë me Platonin janë pika referimi nga më përfaqësuesit në historinë e filozofisë, ishte më shumë i prirur drejt vëzhgimit të botës shqisore. Themelues i logjikës, vepra e tij përfshiu të gjitha fushat. Veprat më kryesore janë Etika e Nikomakut, Politika, Metafizika.                         |
| Epikurizmi                     | Shek. IV-I p.e.s          | Epikuri, Lukreci                                                                                     | Lumturia arrihet duke kuptuar cili është rregulli i funksionimit natyror të botës. Të mësosh të veprosh pa u përballur me ligjet e saj, të ndihmon për të qenë i lumtur. Ndër veprat më të njohura janë Letra e Menecut e Epikurit dhe Mbi natyrën e sendeve e Lukrecit.                               |
| Stoicizmi                      | Shek. IV p.e.s - II p.e.s | Zenoni i Citios, Kleanthi i Azos, Seneka, Epikteti, Mark Aureli                                      | Stoikët vlerësojnë vetëkontrollin dhe ekuilibrin ndërmjet kënaqësive për të shmangur dhimbjen dhe vuajtjet. Nder veprat më të rëndësishme janë Letra për Lucilin e Senekës, Manuali i Epiktetit dhe Meditimet e Mark Aurelit.                                                                          |
| Neoplatonizmi dhe Augustinizmi | Shek. III-IV p.e.s        | Plotini, Shën Agustini                                                                               | Përshtaten përpjekjet për pajtimin e filozofisë platonike me krishtërimin. Plotini ishte më shumë filozof, ndërsa Shën Agustini te "Rrëfimet" dhe "Qyteti i Zotit" përpunoi një filozofi të krishterë.                                                                                                 |
| Skolastika                     | Shek. XI-XIV p.e.s        | Anselmi i Kentëberrit, Alberti i Madh, Shën Tomas Akuini, Roger Bekon, Huan Duns Eskoto, Uiliam Okam | Shpjegimi i krishterimit në mënyrë racionale duke përdorur filozofinë e Aristotelit. Vepra më përfaqësuese është "Përmbledhje teologjike" e Shën Tomas Akunit, në shekullin XII.                                                                                                                       |
| Humanizmi                      | Shek. XIV-XVI p.e.s       | Petrarka, Kampanela, Pomponaci, Montenji, Leonardo da Vinci                                          | Kritikoi skolastikën dhe u përqendrua tek njeriu, marrëdhëniet e tij me artin dhe shkencën, duke filluar nga studimi i dijeve të antikitetit. Eseet e Montenjit e përshkruajnë mjaft mirë këtë mentalitet të ri.                                                                                       |
| Kisha dhe Reforma              | Shek. XV-XVII p.e.s       | Nikola de Kuza, Erazmusi, Martin Luteri, Zhan Kalvin, Makiaveli, Tomas Mor, Zhan Bodin               | Humanizmi ndikoi në mënyrën e kuptimit të fesë. Dëshira për të jetuar fenë, pa ia nënshtruar pushtetit të Kishës, udhëhoqi Reformën e iniciuar nga Luteri dhe çoi në lindjen e fesë protestante.                                                                                                       |
| Filozofia Politike             | Shek. XVI p.e.s           | Makiaveli, Tomas Mor                                                                                 | Reflektimet mbi drejtësinë dhe të drejtën çuan në një përshkrim të realitetit politik të ndryshëm nga shpjegimet e fesë. Te Princi, Makiaveli studion mekanizmat e pushtetit; tek "Utopia", Tomas Mori përfytyron një vend ku mbretëron drejtësia.                                                     |
| Revolucioni Kopernikan         | Shek. XVI-XVII p.e.s      | Koperniku, Xhordano Bruno, Kepler, Galilei, Frensis Bekon                                            | Nisur nga modeli i ri i Kopernikut për universin, shumë shkencëtarë dhe filozofë krijuan shkencën moderne, mbështetur jo te feja apo filozofia, por te matematika dhe eksperimenti. Galilei do të thoshte se "Universi është një libër i hapur i shkruar me gjuhën e matematikës".                     |

|                      |                        |                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------|------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Racionalizmi         | Shekulli XVII          | Dekarti, Spinoza, Melbransh, Lajbnic            | Për Dekartin, ajo që përcakton një qenie njerëzore nuk është aspak fizike, por aftësia për të arsyetuar. Në veprën e tij "Diskutimi mbi metodën", do të shkruante "Mendoj, prandaj ekzistoj". Arsyeja është pikënisja e çdo përvoje të mundshme, falë ekzistencës së ideve të lindura.                                                             |
| Empirizmi            | Shek. XVII-XVIII p.e.s | Tomas Hobs, Xhon Lok, Xhorxh Berkl, Denis Hjum  | E gjithë njohja vjen nga përvoja dhe për më tepër, idetë fitohen dhe nuk janë të lindura. Debati ndërmjet empirizmit dhe racionalizmit do të zotëronte shekujt XVII dhe XVIII, përmes veprave të tilla si "Një ese lidhur me kuptimin njerëzor" e Lokut apo "Nië studim lidhur me të kuptuarit njerëzor" e Hjumit.                                 |
| Lluminizmi           | Shek. XVIII            | Monteskie, Volter, Didërò, Lesing, Rusò, Herder | Njeriu zbulon pushtetin e arsyes mbi natyrën nëpërmjet arritjeve shkencore. Racionaliteti imponohet mbi çdo lloj diskutimi tjetër si feja apo arti. Refleksioni mbi lirinë dhe dinjitetin njerëzor që do të kontribuonte për të ndryshuar mentalitetin mund të gjendet në "Kontratën sociale" të Rusoit, apo në "Frymën e ligjieve" të Monteskies. |
| Idealizmi Gjerman    | Shek. XVIII-XIX        | Kant, Fihte, Shelling, Hegel                    | Filozofia që shpreh vlerat e romantizmit. Konstaton kufizimin e arsyes njerëzore (si Kanti tek "Kritika e arsyes së kulluar"), largësinë ndërmjet njeriut dhe botës apo njeriut dhe Zotit, megjithëse për Hegelin tek vepra e tij "Fenomenologjia e frymës", filozofia duhet të lejojë kuptimin e fatit të njeriut nëpërmjet historisë.            |
| Shopenhaueri         | 1788-1860              | Shopenhaueri                                    | U frymëzua nga Kanti, Platoni dhe kultura e Indisë. Bota nuk më shfaqet ashtu si është, por ashtu si unë e organizoj në sajë të aftësisë sime të të menduarit. "Bota është ideja ime", shkruan ai në veprën e tij "Bota si vullnet dhe ide".                                                                                                       |
| Pozitivizmi          | Shek. XIX              | August Kont                                     | E konsideroi shkencën si kulmin e evolucionit njerëzor dhe rrugën e vetme që mund ti sillte lumturinë njerëzimit.                                                                                                                                                                                                                                  |
| Utilitarizmi         | Shek. XIX              | Xhon Stjuart Mill                               | Teori etike e frymëzuar nga parimet e pozitivizmit, e pasqyruar tek Utilitarizmi i Stjuart Millit, qëllimi i së cilës ishte arritja e lumturisë më të madhe të mundshme për numrin më të madh të mundshëm të njerëzve.                                                                                                                             |
| Marksizmi            | Shek. XIX-XX           | Karl Marks, Engels, A. Gramshi                  | Historia e njerëzimit mund të kuptohet si lufta e vazhdueshme ndërmjet shtypësve dhe të shtypurve, luftë e cila buron nga një organizim i caktuar i veprimtarisë ekonomike, që Marks i analizoi te "Kapitali".                                                                                                                                     |
| Historicizmi         | 1833-1911              | V. Dilthey                                      | Mbrojtja pavarësinë e shkencave të shpirtit kundrejt shkencave të natyrës. Njeriu mëson të njohë vetveten në funksion të historisë së vet. Do të jetë pikënisja e atyre që do të quheshin shkenca humane.                                                                                                                                          |
| Nice                 | 1844-1900              | Nice                                            | Kundërshtar i mashtrimeve të mëdha të qytetërimit perëndimor: shkencës dhe fesë. Krijimi i botëve paralele na ka penguar të sodisim botën e vërtetë të jetës sonë. "Kështu foli Zarathustra" është vepra e tij më e rëndësishme.                                                                                                                   |
| Vitalizmi            | Shek. XIX-XX           | Henri Bergson, Ortega dhe Gaset                 | Për Bergsonin, tek "Evolucioni krijues", jeta është një proces krijues i qëndrueshëm, që vetëm intuita mund ta kuptojë drejt, nëpërmjet përvojës së vet gjatë kohës.                                                                                                                                                                               |
| Psikanaliza          | Shek. XX               | Zigmund Frojd, Erik From, Karl G. Jung          | Frojd, mjek nga profesioni, propozoi falë teorisë së tij mbi të pandërgjegjshmen, një vizion të ri mbi qenien njerëzore dhe kulturën.                                                                                                                                                                                                              |
| Fenomenologjia       | Shek. XX               | E. Huserl, M. Sheler, M. Merlò-Ponti            | Nisur nga një analizë rigoroze e fenomenit të ndërgjegjes, fenomenologjia synon ta kthejë filozofinë në një shkencë që përshkruan me vërtetësi përvojën tonë për botën.                                                                                                                                                                            |
| Filozofia analitike  | Shek. XX               | B. Rasëll, R. Karnap, L. Wittgenstein           | Rrymë filozofike që e kupton filozofinë si një refleksion mbi strukturën logjike të gjuhës. Shumë prej problemeve klasike të filozofisë i konsideron si probleme të thjeshta të gjuhës.                                                                                                                                                            |
| Filozofia e shkencës | Shek. XX               | Popper, Lakatos, Fejerabend, Kuhn               | Shkenca bashkëkohore është e detyruar të ripërcaktojë objektivat e saj dhe për më tepër përcaktimin e vet. E vërteta nuk është qëllimi. Shkenca kërkon të krijojë teori të dobishme.                                                                                                                                                               |
| Ekzistencializmi     | Shek. XX               | Jaspers, Heidegger, Sartre, Camus               | Studion atë që nuk mund të njihet në mënyrë objektive, pra e parë nga jashtë. Ekzistenca e përcakton njeriun si përvoja thelbësore, e cila mund të studiohet vetëm nga brenda dhe që është përpara çdo gjykimi.                                                                                                                                    |

|                        |          |                                                 |                                                                                                                                                                                                                     |
|------------------------|----------|-------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Hermeneutika</b>    | Shek. XX | Gadamer, Ricœur                                 | Studion procesin e kuptimit të veprimeve njerëzore dhe vëzhgon lidhjen me dimensionin historik të realitetit njerëzor. Çdo kuptim varet nga interpretimi dhe konteksti historik.                                    |
| <b>Strukturalizmi</b>  | Shek. XX | Lacan, Barthes, Levi-Strauss, Foucault, Derrida | Studion aspekte të veçanta të realitetit individual dhe kolektiv të njeriut, duke u mbështetur në prurjet e reja të disa shkencave shoqërore si gjuhësia, antropologjia, historia, duke përfshirë dhe psikanalizën. |
| <b>Teoria kritike</b>  | Shek. XX | Adorno, Horkheimer, Marcuse                     | Tre mendimtarë që formojnë atë që është quajtur Shkolla e Frankfurtit. Duke u nisur nga idetë e Marksit, arrijnë në një kritikë radikale të aspekteve të veçanta të shoqërisë moderne.                              |
| <b>Jurgen Habermas</b> | 1929     | Jurgen Habermas                                 | Pasues i shkollës së Frankfurtit, reflekton mbi lidhjet ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe propozon një klasifikim të ri të shkencave. Kohët e fundit i është përkushtuar studimit të komunizmit.                   |
| <b>Postmodernizmi</b>  | Shek. XX | Lyotard, Vattimo                                | Rrymë filozofike që analizon në mënyrë kritike vlerat mbi të cilat mbështetet modernizmi: shkenca, arsyeja, shoqëria e konsumit etj.                                                                                |